

AKT - THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR « 2JDP » shpk

Sot me date **06.04.2022** (dymije e njezete e dy), ditën e marte, ne ortaket:

1. **Ilsidor Prifti**, i biri i Llazar dhe i Arsino, lindur me 30.08.1983, ne Fier dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal I30830067L.
2. **Petrit Jani**, i biri i Jani dhe i Dafina, lindur me 11.08.1981, ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal I10811020K,
3. **Jetion Gjeka**, i biri i Pandeli dhe i Leonora, lindur me 03.09.1989, ne Fier dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, mbajtes i leternjoftimit nr.personal I90903076S,
4. **Jorgji Basho**, i biri i Ilia dhe i Marika, lindur me 15.03.1976, ne Gjirokaster dhe banues ne Andon Poçi, Gjirokaster, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, mbajtes i leternjoftimit nr.personal H60315230P.

Bazuar ne ligjin 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”,

Vendosem

- Te krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar :«**2JDP** » shpk.

Neni 1 EMERTIMI I SHOQERISE

- Shoqerine : «**2JDP**» shpk e krijojme sipas llojit Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, duke e emertuar : «**2JDP**» shpk

Neni 2 KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

- Shoqeria: «**2JDP**» shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 10 vjet. Me vendim te ortakeve te saj ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej

Neni 3 EMERTIMI DHE QENDRA (SELIA)

- Shoqeria « **2JDP** » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne **ADRESEN**: Fier Fier FIER Lagjja 15 Tetori, Rruga Miço Papuçiu, Zona Kadastrale nr 8533, Pasuria nr 7/268-N-13, përball shkollës Mark Dashi.
- Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Ortakeve te Shoqerise.
- Me vendim te ortakeve Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra te tjera perfaqesimi, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

- Kultivimi, mbjellja, rritja, vjelja, perpunimi, importi, eksporti i arroveve, ullirit, sheges, arra, lajthi, bajame.
- Marrja me qira apo me çfrredo lloj forme tjeter te parashikuar nga ligji, i tokave bujqesore me qellim kultivimin e arroveve, ullirit, sheges, arrave, lajthive, bajameve, si dhe çdo produkti tjeter ushqimor, fruta, perime, zarzavate, ereza, etj. Kultivim perpunim, eksport- import, me shumice dhe pakice e çdo produkti ushqimor, lende te pare si dhe te çdo nenprodukti ushqimor te çdo lloji.
- Prodhim primar produktesh ushqimore.
- Prodhim dhe perpunim te lendes se pare ushqimore dhe eksportimin e tyre ne vende te ndryshme, brenda apo jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
- Eksport- Import te çdo makinerie, produkti, fare, fidani, kimikate apo pajisje qe kane lidhje me aktivitetin e siperpermendur, si dhe çdo material tjeter te nevojshem qe lidhet me te.
- Pervet veprimtarive te parashikuara me lart, ne veprimtarine e shoqerise do te hyje çdo veprimtari qe do te konsiderohet nga ortaket se e nevojshme dhe e pershtatshme per arritjen e objektit te shoqerise dhe qe nuk vjen ne kundërshtim me Ligjin Shqiptar.

Neni 5
REGJIMI JURIDIK.

- Ne te gjithe territorin e saj ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria do te udhehiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.
- Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakeve te saj do te percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.
- Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
- Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit, sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.
- Shoqeria gezon afirmimin ligjor qe nga dita e rregjistrimit te saj ne Q.K.B

Neni 6
KAPITALI I SHOQERISE

- Kapitali fillestar i Shoqerise eshte **40 000 (dyzetmije) leke, i ndare ne 4 (kater) kuota.**
- Keto kuota jane teresisht prone e Ortakeve te Shoqerise dhe do te depozitohen si kapital themeltar i Shoqerise «**2JDP**» **shpk** ne banken «UNION BANK» pas rregjistrimit te shoqerise ne QKB.
- Kapitali fillestar i ndare ne perqindje midis ortakeve te shoqerise do te jete si me poshte :
 - **Ilisidor Prifti – 1 kuote = 10 000 (dhjete mije) Leke = 25 % (njetete e pese perqind);**
 - **Petrit Jani – 1 kuote = 10 000 (dhjete mije) Leke = 25 % (njetete e pese perqind);**
 - **Jetion Gjeka – 1 kuote = 10 000 (dhjete mije) Leke = 25 % (njetete e pese perqind);**
 - **Jorgji Basho – 1 kuote = 10 000 (dhjete mije) Leke = 25 % (njetete e pese perqind);**



- Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike, financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne Ortaket e shoqerise per ta rritur ate ne te ardhmen.
- Ne rast vdekjeje te Ortakeve te Shoqerise, pasuria u kalon trashegimtareve te tyre sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 7
DREJTIMI I SHOQERISE

- Fillimisht shoqeria do te udhehiqet, administrohet dhe drejtohet per nje periudhe 5 (Pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje, nga Administratori i shoqerise:
- **Ilsidor Prifti**, i biri i Llazar dhe i Arsino, lindur me 30.08.1983, ne Fier dhe banues ne Fier, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me shtetesi Shqiptare, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal I30830067L, i cili do te jete drejtuesi ligjor i saj, si dhe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet.
- Krahas ecurise se veprimtarise se shoqerise, ne ortaket e saj do te vendosim zgjerimin e organeve te ndryshme te drejtimit dhe te administrimit ekonomik .
- Per cdo ceshtje profesionale si juridike, ekonomike, teknike etj, shoqeria do te angazhoje sipas rastit ne menyre te vijueshme ose te perkoheshme duke punesuar specialiste sipas legjislacionit ne fuqi .

Neni 8
SIGURIMI I PASURISE SE SHOQERISE

- Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese, apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi.
- Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga ne ortaket e shoqerise.

Neni 9
LIKUJDIMI I SHOQERISE

- Rastet e likujdimit te Shoqerise si dhe ai i mbarimit te afatit te aktit te Themelimit te Shoqerise, do te jene ato qe pasqyrohen ne legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Neni 10
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Ky akt per themelimin e Shoqerise ka si pjese te tij edhe Statutin e Shoqerise i cili i bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise, sipas legjislacionit ne fuqi, pushon se vepruari edhe ky Akt - Themelimi.
- Shoqeria « **2JDP** » **shpk** do te kete qendren (seline) e saj ne **ADRESEN**: Fier Fier FIER Lagjja 15 Tetori, Rruga Miço Papuçiu, Zona Kadastrale nr 8533, Pasuria nr 7/268-N-13, përballë shkolles Mark Dashi.

- Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim, te nenshkruhet nga ne ortaket e shoqerise dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj, ashtu si edhe ne Q.K.B.


Ky akt themelimi I shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga ne ortaket e shoqerise, me vullnet te lire dhe te plote.

ORTAKET E SHOQERISE


Isidor Prifti

Isidor Prifti


Petrit Jani

Petrit Jani


Jetion Gjeka

Jetion Gjeka


Jorgji Basho

Jorgji Basho
